



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**  
**E K S T R A K T**

**i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, mbajtur më 6.4.2023, duke filluar në orën 16:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Valbona Ajeti (AAK), kryesuese, Gresa Lahu (PDK), Endrit Zabërgja (NISMA), Petrit Reçica, (LVV), anëtar dhe Adelina Mehiu, eksperte e jashtme.

**Të pranishëm ishin edhe:** Arta Balaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës dhe Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Valbona Ajeti** kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

#### **Rend të ditës:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 2. Planin i punës së komitetit, kalendari i eventeve të kulturës dhe sportit.**
- 3. Informatë specifike në lidhje me dështimin e rregullimit të Kryeqytetit për 15 vjetorin e pavarësisë.**
- 4. Informatë për thirrjen publike, për mbështetje financiare nga Drejtoria e Sportit;**
- 5. Të ndryshme.**

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport**

**Valbona Ajeti, kryesuese konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport**

#### **Pika e dytë**

**Plani i punës së komitetit, kalendari i eventeve të kulturës dhe sportit**

**Valbona Ajeti, kryesuese tha se për çdo vit bëhet një plan i punës në bazë të të cilit do të punojmë gjatë vitit. Unë edhe në mbledhjet e kaluara e kam kërkuar një plan se çka kemi me punuar, duke u bazuar në aktivitetet e dy drejtorive tona, kështu që së bashku e kishim**

**Faqe 1 nga 4**

punuar këtë planin e komitetit, që ndoshta e kishim shkri pak edhe te pika e tretë, te kalendari për ta bërë edhe planin e punës.

**Granit Rugova**, drejtor tha se është mirë me shikuar secili me dhënë një kontribut në bazë të lagjes, shoqërisë, vendit ku jeton, interesat e moshës ose lagjes, çka do qoftë që ka të bëjë me sport, me shikuar mundësinë që me i grumbulluar të gjitha kërkesat të atij komunitetit të sportit edhe me shikuar për buxhet në drejtorinë përkatëse.

**Endrit Zabërgja** tha se Plani i punës së komitetit lidhet ngushtë me kalendarin e eventeve, dhe të aktiviteteve të Drejtorisë së Sportit e që ky kalendar duhet të jetë në bazë të muajve dhe ne si komitet me e u inkorporuar në ato aktivitete që i bënë drejtorja, si në vizita të ndryshme përrurime etj.

Për draftin e planit të punës besoj që na u kish deshtë një tryezë pune, që në një mbledhje tjetër ku bashkërisht besoj që brenda 1-2 orë, kishim mundur me i shpalos disa specifika, sapo të kemi gati edhe kalendarin e aktiviteteve dhe propozoj që takimi i ardhshëm i komitetit të shërbejë si tryezë pune për ta përpiluar bashkërisht.

**Arta Balaj**, drejtoresha tha se ne si drejtori e kemi një draft të kalendarit kulturor, por për të gjitha ato organizime që i bënë drejtorja mvarën edhe pak edhe prej subvencioneve. Natyrisht aktivitetet e drejtorisë prej muajit maj fillojnë të marrin një formë të organizimit. Plani i punës mendoj se duhet bazuar pak edhe në projektet tona kapitale që i kemi, por realizimi i këtij plani mëvaret edhe prej buxhetit që e kemi.

Unë kam vizion për kulturën, shoh koncerte që organizohen, por mua më kanë munguar si p.sh muzika e Jazz-i, e Rokut dhe më shumë kënaqësi po dua ta kthej në skenë një koncert të mirëfilltë, një festival të mirëfilltë të Jazz-it dhe në atë drejtim jam duke punuar.

Po ashtu ne si drejtori duhet ti mbështesim disa organizime si ajo e 'Spice Fire, sepse ato janë duke e bërë ndryshimin kulturor në qytet dhe nuk mundemi si institucion vet me i bërë këto organizime, dhe do të ishte mirë që të na mbështesë edhe niveli qendror. Çdo ide të juajen unë me kënaqësi e pranoj dhe duhet shikuar mundësinë që pasi në muajin qershor kemi me bërë planifikimin e buxhetit.

**Granit Rugova**, drejtor tha se çdo aktivitet sportiv po mvarret prej subvencioneve. Janë ardhur vetëm 18 aktivitete që janë mbajtur në Prishtinë, a në fakt gjatë vitit në Prishtinë janë përmbytur 200 aktivitete sportive që mbahen, por edhe disa prej tyre nga këto 18 aktivitete janë pikëpyetje sa përkrahen, qysh përkrahen, a kanë me u mbajtur, kështu që duhet me prit edhe pak deri sa të bëhet ndarja e subvencioneve, sidomos në pjesën e verës mundemi me e ditur sa ka me pas aktivitete. Ne përveç se e i përkrahim financiarisht, na si drejtori ju ndihmojmë edhe në organizim, promovim etj.

Në vazhdim cekim se Drejtorja e Sportit për këtë vit në program i ka 8 projekte për realizim:

1. Ndërtimi i sallës multifunktionale;
2. Vazhdimi i ndërtimit të tribunës lindore të stadiumit "2 korriku";
3. Ndërtimi i tribunës së stadiumit "Ramiz Sadiku";
4. Renovimi i shtegut në Tauk-bahqë;
5. Dy zhveshtore, në FC Prishtina dhe Kosova e Prishtinës;

Faqe2nga4

6. Ndërtimi i terreneve dhe hapësirave sportive në Mat dhe Hajvali;
7. Ndërtimi i terrenit për moto kros;
8. Ndërtimin e 4 fushave të futbollit, në Bardhosh, Barilevë, Matiqan dhe në Bërniceë.

**Petrit Reçica** kërkoi të dijë se çka do të bëhet me sallën e vjetër në Pallatin e Rinisë dhe lidhur me këtë ceku se, sipas informacioneve që kamë, Ministria e Sportit ka vullnet me investuar dhe me e me kthyer në gjendje të më parshme, pa si që ne nuk kemi sallë të madhe, dhe desha ta di se Drejtoria e Sportit a ka ndonjë plan për këtë sallë.

**Granit Rugova**, drejtor tha se sa i përket renovimit të sallës së madhe në Pallatin e Rinisë, Drejtoria e Kulturës dhe përkundër një iniciative të marrë nga ne, për një bashkëfinancim me ministrinë përkatëse për renovimin e saj, në mungesë të vullnetit për bashkëpunim, projekti nuk u realizua.

#### **Pika e tretë**

#### **Informatë specifike lidhur me dështimin e dekorimit të Kryeqytetit për 15 vjetorin e Pavarësisë së 17 shkurtit**

Lidhur me Informatën rreth dështimit të dekorimit të Kryeqytetit për 15 vjetorin e Pavarësisë së 17 shkurtit, Arta Balaj, drejtorë i njoftoi të pranishmit duke shtuar se, Drejtoria e Kulturës nuk e ka pasur për obligim dekorimin e kryeqytetit me rastin e 15 vjetorit të Pavarësisë së 17 shkurtit. Për dekorimin e qytetit ka qenë e angazhuar Drejtoria e Shërbimeve Publike, por të vetmin dekorim që e kemi përgjegjësi është për fundvit.

**Endrit Zabërgja** tha se organizimi i eventit për Ukrainën ishte aq mirë, ndërsa për Ditën e pavarësisë së 17 shkurtit është për të ardhur keq dhe kisha kërkuar që herëve tjera të mos na përsëritet kjo. Sipas informacioneve që kemi në momentin e fundit, Drejtoria e Kulturës ka hy me Hortikulturën me bë diçka me vullnetarizëm.

#### **Pika e katërt**

#### **Informatë për thirrjen publike për mbështetje financiare nga Drejtoria e Sportit**

**Granit Rugova**, drejtor tha se një fazë e kemi paraparë për klube dhe dy faza për OJQ rinore dhe për aktivitete sportive. Faza e dytë parashihet nga gushti deri në dhjetor, që brenda kësaj kohe për ti mbajtur aktivitetet.

**Endrit Zabërgja** kërkoi të dijë se a është ndonjë fond i ndarë për evente sportive dhe ndonjë fond për OJQ-të rinore, apo cila të fiton varësisht prej garave.

**Granit Rugova**, drejtor tha se këto janë të ndara, d.m.th në parim për krejt subvencionet e drejtorisë, rreth 20% shkojnë veç për OJQ-të rinore, aktivitete rinore, 15% shkon në sport, kurse projektet tjera shkojnë te klubet.

**Arta Balaj**, drejtorë tha se pasi që ende ka kohë për të aplikuar për kulturë, për ndonjë organizim me ide të mira kreative, le të aplikojnë.

**Pika e pesë  
Të ndryshme**

**Valbona Ajeti**, kryesuese kërkoi nga znj, Balaj që të paraqesë një informatë rreth projektit të "Kurrizit".

**Arta Balaj**, drejtoresha tha se adaptimi i tunelit të "Kurrizit", ka përfunduar matja gjeodezike dhe jemi duke pritur nga investimet kapitale, planin zbatues, sepse ai ka qenë vetëm plani ideor dhe ne duhet me ditë konkretisht çka duhet më tutje.

**Petrit Reçica** kërkoi një përgjigje nga drejtorja lidhur me një njoftim rreth një kontrate, ku titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues është: Shërbimi për organizimet dhe manifestimet kulturore të Kryeqytetit, shuma e mjeteve rreth 320 mijë euro.

**Arta Balaj**, drejtoresha tha se kjo është kontrata për bina, për zërim që bëhet për çdo vit.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:10.*

**Procesmbajtësi  
Arton Brahim**

**Kryesuesja e komitetit  
Valbona Ajeti**



**Faqe4nga4**